www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 200

Tiranë – E mërkurë, 27 nëntor 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 109/2024, datë 31.10.2024	Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.....	21919
Dekret i Presidentit nr. 394, datë 25.11.2024	Për shpallje ligji.....	21931
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 75, datë 28.10.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 10342, datë 28.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; pikës 2, të vendimit nr. 212, datë 29.1.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimit nr. 00-2023-4924(683), datë 22.11.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	21931
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 980, datë 15.11.2024	Për përcaktimin e formës dhe mënyrës së paraqitjes së kërkesës për miratimin si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parqeve teknologjike dhe shkencore.....	21941

LIGJ
Nr. 109/2024

PËR SHKENCËN DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave për organizimin dhe funksionimin e sistemit të shkencës dhe të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj është i zbatueshëm për çdo institucion apo entitet, që është pjesë e sistemit të shkencës dhe kërkimit shkencor. Ky ligj është i zbatueshëm për institucionet e arsimit të lartë për aq kohë sa nuk vjen në kundërshtim me ligjin e arsimit të lartë.

Neni 2
Qëllimi dhe objektivat

1. Ky ligj ka për qëllim krijimin e kushteve për zhvillimin dhe funksionimin e një sistemi bashkëkohor të shkencës dhe kërkimit shkencor, dhe rregullimin e garantimin e mundësimit të financimit të këtij sistemi nga burime të ndryshime financimi, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

2. Ligji synon arritjen e objektivave si më poshtë:

a) sigurimin e produkteve të kërkimit shkencor, që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik, si dhe konsolidimin e identitetit dhe mbrojtjen e interesave kombëtarë;

b) përvetësimin e aftësive dhe të njohurive të reja, transferimin e tyre për përfitimin e përgjithshëm publik, me synim rritjen e nivelit të mirëqenies sociale, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit;

c) fuqizimin e aftësive për të menaxhuar dhe zbatuar progresin teknologjik, dhe të përgjithshëm shoqëror, si burimi kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm, duke rritur vlerën e punës e konkurrueshmërinë;

ç) fuqizimin e lidhjeve ndërkombëtare të komunitetit të studiuesve dhe të kërkuesve shkencorë shqiptarë me ata të zonës evropiane të kërkimit, si dhe me kërkuesit e diasporës, duke promovuar lëvizshmërinë dhe përfshirjen në proceset e integrimit evropian;

d) ngritjen e kapaciteteve të personelit shkencor dhe nxitjen e zhvillimit të karrierës shkencore, duke siguruar mundësi të barabarta;

dh) fuqizimin dhe rritjen e përdorimit të infrastrukturës kërkimore-shkencore, duke garantuar akses për të gjithë;

e) zgjerimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e kërkimit shkencor, me qëllim zhvillimin e shfrytëzimin e potencialeve kërkimore-shkencore;

ë) nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të kërkimit shkencor dhe biznesit, institucioneve publike, shoqërisë civile, si dhe palëve të tjera të interesuara në veprimtari kërkimore-shkencore dhe inovacion;

f) promovimin, zgjerimin e rolit të shkencës dhe krijimin e një mjedisi favorizues e mbështetës për kërkimin shkencor në shoqëri.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Fushat e kërkimit shkencor" janë veprimtaritë për nxitjen e dijes e të vërtetës shkencore, mbrojtjen e shëndetit publik, të trashëgimisë kulturore, mjedisore dhe materiale, nxitjen e teknologjisë dhe inovacionit etj.

2. "Fushat e kërkimit shkencor të një rëndësie të veçantë" janë fushat e kërkimit shkencor, që lidhen me sigurinë kombëtare, të drejtat e njeriut, shëndetin publik dhe mjedisin.

3. "Fushat prioritare" janë fushat kërkimore, të cilat shpallen si të tilla nga ministria për shkak të interesit të përbashkët kombëtar në funksion të zhvillimit të vendit.

4. "Entitet" është personi juridik i krijuar dhe i regjistruar në varësi të formës së organizimit të tij, i cili, referuar objektit të aktivitetit të tij, është konceptuar për të ushtruar veprimtari në fushën e kërkimit shkencor për krijimin e një/disa produkti/eve apo shërbimi inovativ dhe/ose teknologjik të veçantë, me potencial rritjeje të cilësisë dhe/ose shpejtësisë dhe të zbatueshëm në praktikë.

5. "Kërkimi bazë" është veprimtari eksperimentale ose teorike e ndërmarrë kryesisht për të përvetësuar njohuri të reja për aspektet themelore të fenomeneve dhe fakteve të vëzhgueshme pa ndonjë zbatim apo përdorim të veçantë në vështrim.

6. "Kërkimi i aplikuar" janë të gjitha veprimtaritë krijuese origjinale për të përftuar njohuri të reja, që synojnë kryesisht një objektiv ose zbatim praktik.

7. "Zhvillimi eksperimental" është punë sistematike, e cila mbështetet në njohuritë e marra nga përvoja kërkimore e praktike dhe prodhon njohuri shtesë, e cila ka për qëllim prodhimin e produkteve ose të proceseve të reja, ose përmirësimin e produkteve ose të proceseve ekzistuese.

8. "Inovacioni" është përfshirja e një produkti, shërbimi ose procesi si një metodë e re për organizimin e punës, prodhimin e produkteve, si dhe mënyrën e menaxhimit, e cila përmirëson performancën e institucionit të kërkimit shkencor.

9. "Ministri" është ministri përgjegjës për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë.

10."Ministria" është ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë.

11."Menaxhimi i riskut në kërkimin shkencor" është vlerësimi në çdo projekt kërkimor i mundësisë së ardhjes së një dëmi, që cenon sigurinë kombëtare, të drejtat e njeriut, shëndetin publik dhe mjedisin.

12."Subjektet publike të kërkimit shkencor" janë institucionet, institutet dhe njësitë e veçanta të krijuara si persona juridikë publikë, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

13."Subjektet jopublike të kërkimit shkencor" janë institucionet, institutet dhe njësitë e veçanta të krijuara nga persona fizikë ose juridikë, subjekte të së drejtës private, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

14."Punonjësi kërkimor-shkencor" është individi i angazhuar në veprimtari të kërkimit shkencor, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

15."Sistemi i shkencës" është tërësia e institucioneve politikëbërëse, që drejtojnë, vlerësojnë, financojnë dhe ushtrojnë veprimtaritë e kërkimit dhe të zhvillimit shkencor, inovacionit dhe transferimit të teknologjisë.

16."Veprimtari kërkimore-shkencore" është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga kërkuesi, individi, grupi i individëve apo struktura të posaçme të ngritura sipas këtij ligji, me qëllim që të gjenerojë njohuri, studime apo aplikime të reja.

17."Pezullimi i veprimtarisë kërkimore" është heqja e së drejtës për të ushtruar veprimtarinë kërkimore-shkencore deri në përmbushjen e kushteve të vendosura nga ministria për plotësimin e kritereve për ushtrimin e veprimtarisë së institutit dhe të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

Neni 4

Parimet bazë të sistemit të shkencës dhe të kërkimit shkencor

Veprimtaritë e sistemit të shkencës dhe të kërkimit shkencor udhëhiqen nga këto parime:

1. Liria e kërkimit shkencor nënkupton të drejtën e çdo individi, institucioni, njësie kërkimore-shkencore dhe entiteti të ngritur në përputhje me këtë ligj, për t'i garantuar lirinë e mendimit dhe shprehjes, lirinë për të identifikuar dhe përcaktuar metodat kërkimore dhe parimet bazë metodologjike, lirinë për të zgjedhur dhe zhvilluar teori dhe ide të reja shkencore, lirinë për vlerësimin e rezultateve kërkimore dhe përhapjen e tyre, si dhe lirinë për t'u bashkuar në organe profesionale ose përfaqësuese.

2. Ofrimi i mundësive të barabarta nënkupton që institucionet, institutet dhe njësitë e veçanta u ofrojnë të gjitha subjekteve gjatë ushtrimit të veprimtarisë shmangien e çdo pabarazie pa arsye objektive, si dhe duke i trajtuar ato në mënyrë të drejtë e të paanshme.

3. Mosdiskriminimi i subjekteve në veprimtaritë kërkimore-shkencore nënkupton eliminimin e pabarazive, që lidhen me moshën, aftësinë e kufizuar, racën, përkatësinë etnike, fenë, besimin dhe orientimin seksual.

4. Barazia gjinore në veprimtaritë kërkimore-shkencore nënkupton eliminimin e paragjykimeve dhe të pabarazive gjinore për të përmirësuar ekuilibrin mes punës e jetës dhe promovimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

5. Transparenca nënkupton ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në mënyrë transparente të institucioneve që drejtojnë, vlerësojnë, financojnë dhe ushtrojnë veprimtaritë e kërkimit dhe të zhvillimit shkencor, inovacionit e transferimit të teknologjisë.

6. Shkenca e hapur nënkupton se veprimtaria kërkimore-shkencore krijon mundësi të pjesëmarrjes dhe të përdorimit të produktit shkencor nga studiuesit dhe publiku pa kufizim.

7. Konkurrenca në shkencë nënkupton se veprimtaria kërkimore-shkencore është e bazuar në kushte të njëjta dhe të barabarta për të gjitha palët e përfshira në këtë veprimtari.

8. Cilësia në shkencë nënkupton respektimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë veprimtarisë së kërkimit shkencor.

9. Efikasiteti në shkencë nënkupton aftësinë e matshme të veprimtarisë në kërkimin shkencor.

10.Etika në shkencë nënkupton vlerësimin e sjelljes gjatë veprimtarisë së kërkimit shkencor.

11.Përgjegjshmëria në shkencë nënkupton monitorimin e veprimeve ose të mosveprimeve, në përputhje me detyrimet në fuqi gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore.

12.Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional nënkupton realizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore, duke u bazuar në bashkëpunimin e koordinimin ndërinstitucional, duke respektuar në mënyrë të ndërsjellë detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të çdo institucioni, si dhe parimet e zonës evropiane të kërkimit (ERA).

13.Financimi eficient nënkupton financimin e veprimtarive kërkimore-shkencore dhe inovative, duke siguruar barazi, eficiencë, efektivitet dhe transparencë të përdorimit të fondeve.

Neni 5
Shkenca e hapur

1. Institucionet që zhvillojnë kërkim shkencor, të financuara apo të bashkëfinancuara me mjete financiare publike, zbatojnë parimin e shkencës së hapur.

2. Të dhënat dhe produktet e kërkimit shkencor, të financuara e të bashkëfinancuara me fonde publike, janë të hapura, të aksesueshme, ndërvepruese dhe të ripërdorshme, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve të vendosura nga mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale, mbrojtja e të dhënave personale, si dhe siguria e individëve ose e shtetit.

3. Kërkuesit shkencorë ose çdo përfitues i financimit publik të kërkimit shkencor i bën publikimet e tij të disponueshme dhe të aksesueshme për publikun.

4. Parimi i shkencës së hapur dhe praktikat që e stimulojnë atë janë kritere të vlerësimit të institucioneve, projekteve kërkimore dhe të karrierës së kërkuesit shkencor.

5. Infrastruktura e kërkimit shkencor është e hapur, duke bërë të mundur që kërkuesit shkencorë të ndajnë dhe të përpunojnë rezultatet e të dhënave të kërkimit, të financuara ose të bashkëfinancuara me fonde publike, përtej kufijve kombëtarë dhe pavarësisht fushës së kërkimit shkencor.

6. Standardet dhe kriteret, që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur dhe janë në përputhje me politikat e zonës evropiane të kërkimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6
Fushat e kërkimit shkencor dhe klasifikimi i nënfushave të kërkimit shkencor

1. Fushat e kërkimit shkencor janë fushat e njëjta apo të ngjashme me ato evropiane të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtar.

2. Klasifikimi i fushave dhe i nënfushave të kërkimit shkencor i referohet Manualit të Fraskatit të OECD-së.

KREU II
ORGANIZIMI I SISTEMIT TË SHKENCËS DHE TË KËRKIMIT SHKENCOR

Neni 7
Sistemi i shkencës dhe i kërkimit shkencor

1. Sistemi i shkencës dhe i kërkimit shkencor përfshin institucionet politikëbërëse, zhvilluese, financuese dhe vlerësuese të veprimtarisë së kërkimit shkencor.

2. Institucionet politikëbërëse janë Këshilli i Ministrave, ministria dhe Këshilli Kombëtar për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor.

3. Institucionet zhvilluese janë Akademia e Shkencave, institucionet e arsimit të lartë, institucionet apo institutet e krijuara me akte të posaçme, tregtarët dhe shoqëritë tregtare, dhe çdo

institucion apo entitet publik apo jopublik, i cili krijohet dhe vepron sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Institucionet financuese janë Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe çdo institucion apo organizatë tjetër publike ose jopublike, që financon sistemin e shkencës dhe kërkimin shkencor.

5. Institucioni vlerësues i veprimtarisë së kërkimit shkencor është ministria. Përjashtohen nga ky rregullim vlerësimi i veprimtarisë kërkimore dhe shkencore në institucionet e arsimit të lartë që vlerësohen në përputhje me dispozitat e ligjit për arsimin e lartë.

Neni 8
Ministria dhe ministri përgjegjës

1. Ministria është institucioni përgjegjës që harton, drejton, koordinon dhe realizon politikat e programit qeverisës në fushën e shkencës dhe të kërkimit shkencor. Ministria vlerëson sipas përcaktimeve të këtij ligji veprimtarinë kërkimore të institucioneve të kërkimit shkencor, financuar me fonde publike, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe administron Regjistrin Kombëtar të Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë.

2. Ministri ka këto kompetenca:

a) harton politika në fushën e shkencës dhe të kërkimit shkencor, si dhe i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e strategjisë në këtë fushë;

b) propozon në Këshillin e Ministrave modelin e financimit të buxhetit për shkencën dhe kërkimin shkencor, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi;

c) harton dhe propozon për miratim pranë Këshillit të Ministrave Kodin e Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor të harmonizuar me Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor.

Neni 9
Këshilli Kombëtar për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor

Këshilli Kombëtar për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor është një organ këshillimor i ngritur pranë Kryeministrit, që ka për detyrë të ndikojë për përmirësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në vend, duke dhënë rekomandime lidhur me të.

Neni 10
Përbërja e Këshillit Kombëtar për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor

1. Këshilli Kombëtar për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor drejtohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga 19 anëtarë si më poshtë:

a) ministri përgjegjës për shkencën;
b) ministri përgjegjës për inovacionin;
c) ministri përgjegjës për energjinë;
ç) ministri përgjegjës për bujqësinë;
d) ministri përgjegjës për shëndetësinë;
dh)ministri përgjegjës për mbrojtjen;
e) ministri përgjegjës për mjedisin;
ë) pesë përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë;
f) tre përfaqësues të Akademisë së Shkencave;
g) dy përfaqësues të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore;
gj) përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;
h) përfaqësues i Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës.

2. Anëtarët e këtij Këshilli, përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, janë personalitete të njohura në fushën e shkencës dhe të kërkimit shkencor, të caktuar nga Konferenca e Rektorëve.

3. Anëtarët e këtij Këshilli, përfaqësues të qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, janë personalitete të njohura në fushën e shkencës dhe të kërkimit shkencor, të caktuar nga ministri përgjegjës për bujqësinë.

4. Anëtarët e këtij Këshilli qëndrojnë në detyrë për sa kohë ushtrojnë detyrën në institucionet e përfaqësuara sipas pikës 1 të këtij neni, apo nuk janë liruar nga ky Këshill nga institucioni që i ka caktuar.

5. Organizimi, funksionimi dhe rastet e lirimit të anëtarëve të këtij Këshilli përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11
Detyrat e Këshillit Kombëtar për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor

Këshilli Kombëtar për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor ka këto detyra:

1. Orienton politika mbështetëse për shkencën dhe kërkimin shkencor.

2. Rekomandon fushat prioritare të shkencës e të kërkimit shkencor dhe mekanizmat e mbështetjes.

3. Jep mendim në hartimin e Strategjisë Kombëtare të Shkencës dhe Kërkimit Shkencor apo dokumente të ngjashme, si programet afatmesme e afatgjata të zhvillimit të shkencës e inovacionit për fusha të rëndësishme të shkencës.

4. Analizon Sistemin Kombëtar të Shkencës e të Kërkimit Shkencor, si dhe ecurinë drejt integrimit të sistemit në zonën evropiane të kërkimit (ERA), duke rekomanduar përmirësimin e tij sipas rastit.

KREU III
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I KËRKIMIT SHKENCOR

Neni 12
Institucionet, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor

1. Kërkimi shkencor në Republikën e Shqipërisë realizohet nga persona juridikë, publikë ose jopublikë, të organizuar në institucione të kërkimit shkencor, institute dhe njësi të veçanta të kërkimit shkencor, të ngritura për të kryer veprimtari në fushën e shkencës e të kërkimit shkencor.

2. Institucionet pranë të cilave kryhet veprimtaria e kërkimit shkencor, që organizohen dhe funksionojnë sipas akteve ligjore të posaçme, janë:

a) Akademia e Shkencave;

b) institucionet e arsimit të lartë;

c) parqet teknologjike dhe shkencore;

ç) qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore;

d) institucione të tjera të krijuara me ligje të posaçme.

3. Instituti i Kërkimit Shkencor përbëhet nga jo më pak se dy njësi të kërkimit shkencor, të organizuara në formën e departamentit, qendrës kërkimore, laboratorit kërkimor ose qendrës eksperimentale, që zhvillojnë dhe mbështesin veprimtarinë kërkimore-shkencore në përputhje me këtë ligj.

4. Njësitë e kërkimit shkencor të organizuara në formën e departamentit, qendrës kërkimore, laboratorit kërkimor dhe qendrës eksperimentale e ushtrojnë aktivitetin si pjesë përbërëse e instituteve të kërkimit shkencor.

5. Njësitë e veçanta të kërkimit shkencor organizohen si njësi të kërkimit shkencor, që realizojnë kërkim shkencor në fusha të veçanta të organizuara sipas legjislacionit në fuqi.

6. Për interesa të përbashkëta kërkimorë, studimorë dhe zhvillimorë, institutet apo njësitë e kërkimit shkencor mund të bashkëpunojnë në kuadër të marrëveshjeve të përbashkëta në përputhje me aktet rregullatore të tyre.

7. Institucionet sipas shkronjave "c" dhe "ç", të pikës 2 të këtij neni dhe institucione të tjera të ngjashme në varësi të ministrive të linjës organizohen dhe funksionojnë me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për fushën dhe krahas kërkimit shkencor kryejnë funksione dhe detyra të përcaktuara në vendim.

Neni 13
Instituti i Kërkimit Shkencor

1. Instituti i Kërkimit Shkencor ka për objekt kërkimin shkencor e zbatimin e tij në një apo disa fusha të shkencës.

2. Organet drejtuese të Institutit të Kërkimit Shkencor janë Këshilli Shkencor dhe drejtuesi i Institutit të Kërkimit Shkencor, i cili i përket të paktën kategorisë "kërkues shkencor i avancuar".

3. Këshilli Shkencor i Institutit të Kërkimit Shkencor është organi më i lartë vendimmarrës për drejtimin dhe vlerësimin e veprimtarisë shkencore të tij. Këshilli Shkencor përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë, që përfaqësojnë njësitë përbërëse të institutit të kërkimit shkencor.

4. Këshilli Shkencor i Institutit të Kërkimit Shkencor ka këto kompetenca:

a) përcakton politikat dhe planin strategjik të lidhura me fushat e kërkimit shkencor në përputhje me misionin e institutit të kërkimit shkencor;

b) miraton rregulloren e brendshme të institutit të kërkimit shkencor;

c) miraton raportin, planin vjetor dhe afatmesëm të veprimtarisë kërkimore-shkencore;

ç) shqyrton dhe miraton marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në përputhje me fushën e tij të veprimtarisë;

d) miraton rregulloren e komitetit të etikës;

dh) nxit dhe mbështet zhvillimin e karrierës profesionale të punonjësve kërkimorë-shkencorë.

5. Përbërja, organizimi, mënyra e përzgjedhjes dhe kompetencat e tjera të Këshillit Shkencor përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli Shkencor.

6. Drejtuesi i Institutit të Kërkimit Shkencor zgjidhet ose emërohet sipas përcaktimeve në aktin e krijimit.

7. Drejtuesi i Institutit të Kërkimit Shkencor është përfaqësuesi i tij dhe drejton Këshillin Shkencor.

8. Struktura, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i Institutit të Kërkimit Shkencor përcaktohen në aktin e krijimit.

Neni 14

Njësitë e veçanta të kërkimit shkencor

1. Njësitë e veçanta të kërkimit shkencor organizohen si departamente, qendra kërkimore, laboratorë kërkimorë ose qendra eksperimentale dhe e ushtrojnë aktivitetin edhe pa qenë pjesë e një institucioni të krijuar me ligj të posaçëm ose e një instituti kërkimor-shkencor.

2. Organi drejtues i njësisë së veçantë të kërkimit shkencor është drejtuesi i njësisë, i cili i përket të paktën kategorisë "kërkues shkencor". Procedurat e emërimit dhe e largimit të drejtuesit të njësisë përcaktohen në aktin e krijimit.

3. Njësitë e veçanta të kërkimit shkencor kanë në përbërje të tyre jo më pak se tre anëtarë, nga të cilët dy anëtarë i përkasin të paktën kategorisë "kërkues shkencor" dhe një anëtar "asistent kërkues shkencor".

4. Struktura, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i njësisë së veçantë të kërkimit shkencor përcaktohen në aktin e krijimit.

Neni 15

Bashkëpunimi i institucioneve, i instituteve dhe i njësive të veçanta të kërkimit shkencor

1. Institucionet e krijuara me ligje të posaçme, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, si dhe me institucione e njësi të tjera, publike ose jopublike, vendase ose të huaja, qendrat e transferimit të teknologjive, parqet teknologjike, njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit, me qëllim realizimin e misionit të tyre në fushën e kërkimit shkencor.

2. Bashkëpunimi në fushën e kërkimit shkencor me IAL-të bëhet kryesisht me qëllim:

a) vënien në dispozicion të infrastrukturës dhe burimeve njerëzore për zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë pranë institucioneve të arsimit të lartë.

b) zhvillimin e projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor;

c) zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit të produkteve në një fushë të caktuar me interes specifik në zhvillimin ekonomik dhe social;

ç) shkëmbimin e informacionit, të dijeve, inovacionit dhe produkteve të kërkimit.

KREU IV

KRIJIMI, REGJISTRIMI, LEJIMI, PEZULLIMI, MBYLLJA DHE VLERËSIMI I INSTITUTEVE DHE I NJËSIVE TË VEÇANTA TË KËRKIMIT SHKENCOR

Neni 16

Krijimi i instituteve dhe i njësive të veçanta të kërkimit shkencor

1. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor krijohen sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe e fillojnë ushtrimin e aktivitetit me hyrjen në fuqi të aktit të krijimit. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, pjesë e institucioneve të krijuara me ligj të posaçëm, krijohen dhe e ushtrojnë aktivitetin sipas përcaktimeve në ligjin e krijimit.

2. Në aktin e krijimit të institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor përcaktohen të paktën:

a) lloji;

b) emri dhe selia;

c) misioni, objekti dhe fusha e veprimtarisë;

ç) struktura organizative.

3. Riorganizimi i brendshëm i institutit dhe i njësive të veçanta të kërkimit shkencor bëhet me propozim të një ose të disa njësive përbërëse dhe miratim të organit që miraton strukturën dhe organikën.

4. Kriteret dhe procedurat për krijimin e instituteve dhe të njësive të veçanta publike të kërkimit shkencor, si dhe krijimi i tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17
Statuti dhe aktet e brendshme të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor

Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor e rregullojnë veprimtarinë e tyre në bazë të këtyre akteve:

1. Statutit, i cili përmban normat bazë, që rregullojnë veprimtarinë e institutit dhe të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, dhe miratohet nga organi drejtues i tij. Në statut, në përputhje me aktin e krijimit të institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, përcaktohen: organizimi, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e organeve drejtuese, zgjedhja apo emërimi i tyre, si dhe çështje të tjera, që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

2. Rregulloret e instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor e rregullojnë veprimtarinë e tyre të brendshme në zbatim të ligjit, statutit e programit të tij. Ato hartohen e miratohen në përputhje me këtë ligj dhe sipas mënyrës së përcaktuar në statutin e institutit dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor.

3. Kodi i etikës së institutit dhe i njësisë së veçantë të kërkimit shkencor miratohet në përputhje me parimet e përgjithshme të etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor nga struktura drejtuese e entitetit.

4. Dokumenti strategjik përcakton vizionin, misionin, objektivat afatgjatë të institutit dhe të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor.

5. Plani për barazinë gjinore nxit pjesëmarrje e trajtim të barabartë gjinor në organizimin e organeve drejtuese dhe veprimtaritë kërkimore.

Neni 18
Regjistri Kombëtar i Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë

1. Regjistri Kombëtar i Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë është regjistër, ku regjistrohen dhe ruhen të dhëna për institucionet e kërkimit shkencor dhe kërkuesit shkencorë. Ky regjistër mbahet dhe administrohet nga struktura përgjegjëse në ministri.

2. Në këtë regjistër pasqyrohen të dhënat e aktit të krijimit të institucionit të krijuar me ligj të posaçëm, instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

3. Forma, përmbajtja, elementet e regjistrit dhe procedurat e krijimit, administrimit të informacionit, si dhe dokumentacioni që depozitohet për regjistrim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19
Leja për ushtrimin e veprimtarisë në një fushë të një rëndësie të veçantë

1. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, që krijohen për të ushtruar veprimtarinë e tyre në fusha të një rëndësie të veçantë, pajisen me lejen përkatëse nga ministri.

2. Me këtë leje pajisen edhe institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, të cilat shtojnë në aktivitetin e tyre veprimtarinë në fushat e një rëndësie të veçantë të kërkimit shkencor dhe plotësojnë kriteret përkatëse.

3. Fushat e rëndësisë së veçantë të kërkimit shkencor për të cilat kërkohet leje e veprimtarisë kërkimore-shkencore, si dhe kriteret e procedurat për lëshimin e lejes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20
Vlerësimi i instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor

1. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, të cilat financohen nga fonde publike, sipas këtij ligji, i nënshtrohen periodikisht vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve të funksionimit nga strukturat përgjegjëse në ministri.

2. Kriteret, procedurat, periodiciteti dhe metodologjia e këtij vlerësimi, si dhe llojet e masave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21
Pezullimi, mbyllja e institutit dhe njësisë së veçantë të kërkimit shkencor

1. Në rast se nga vlerësimi dhe monitorimi i veprimtarisë nga ministria konstatohet që instituti ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor nuk përmbush kriteret e funksionimit, ministri vendos kushte për vijimin e veprimtarisë nën mbikëqyrje të

ministrisë ose pezullimin e veprimtarisë deri në plotësimin e kushteve, për një periudhë jo më të gjatë se dy vite kalendarike. Rregullat dhe procedurat për vendosjen nën mbikëqyrje, pezullimin dhe mbylljen e institutit dhe të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Veprimtaria e institutit ose e njësisë së veçantë të kërkimit shkencor mbyllet me propozimin e ministrit nga organi që e ka krijuar në rastet e mëposhtme:

a) me iniciativën e vetë institutit apo të njësisë;

b) në rastet e mbarimit të personalitetit juridik të institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, kur gëzon personalitet juridik sipas parashikimeve ligjore;

c) për shkak të shkeljeve të rënda ligjore në kryerjen e veprimtarisë së tij, të konstatuara nga kontrolli i ligjshmërisë, i cili realizohet së paku një herë në tre vjet nga strukturat përgjegjëse në ministri;

ç) për shkak të mospërmbushjes së misionit për 24 (njëzet e katër) muaj nga data e hyrjes në fuqi të aktit të krijimit;

d) për shkak të vlerësimit negativ të përsëritur pa ndërprerje të ministrisë;

dh)në rastin e konstatimit të shkeljeve nga auditimi financiar, i cili realizohet së paku një herë në dy vjet nga ministria.

3. Akti për mbylljen e institutit ose të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor depozitohet pranë Regjistrit Kombëtar të Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë.

Neni 22
Statusi "qendër ekselence" dhe "njësi e posaçme"

1. Instituti dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor për rezultate të spikatura në nivel kombëtar ose ndërkombëtar në fushën e kërkimit apo për zhvillimin e kërkimit shkencor në fusha prioritare mund të fitojnë statusin "qendër ekselence".

Institutet apo njësitë e veçanta me statusin "qendër ekselence" mund të përfitojnë fonde grant të dedikuara për kërkimin shkencor.

Dhënia e statusit "qendër ekselence" propozohet nga ministri për një afat kohor të përkohshëm apo të përhershëm dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret dhe procedurat për dhënien e statusit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Struktura të ndryshme publike të kërkim-zhvillimit mund të fitojnë statusin "njësi e posaçme", si njësi, që krahas veprimtarisë kërkimore kryesisht në zbatim, eksperimentimin e përhapjes së arritjeve, të produkteve e teknologjive të reja, mund të kryejnë edhe trajnimin e specialistëve e të kërkuesve të rinj në fusha specifike, në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë sipas programeve dhe fushës së kërkimit që ato realizojnë, si dhe në kuadër të veprimtarisë shkencore të aplikuar në fushën ku zhvillojnë aktivitetin e kërkimit.

3. "Njësia e posaçme" mund të financohet drejtpërdrejt nga ministria e linjës, institucioni publik i arsimit të lartë, institucione publike dhe jopublike apo subjekte private biznesi nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit në kuadër të veprimtarive të kërkim-zhvillimit.

4. "Njësia e posaçme" mund të sigurojë të ardhura të veta nëpërmjet shërbimeve të kualifikuara për të tretë sipas tarifave të miratuara nga organet e saj drejtuese.

5. Statusi "njësi e posaçme" jepet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për shkencën dhe të fushës përkatëse të kërkimit pas marrjes së mendimit nga institucioni publik i arsimit të lartë. Masa dhe mënyra e pagesës për stafin akademik dhe atë kërkimor-shkencor të angazhuar nga IAL-i përcaktohen në status. Modalitetet dhe procedurat e bashkëpunimit midis njësisë, institucionit publik të arsimit të lartë dhe subjektit privat, në rast se ka të tillë, rregullohen me marrëveshje të përbashkët ndërmjet palëve.

KREU V
PERSONELI KËRKIMOR-SHKENCOR

Neni 23
Personeli i instituteve dhe i njësive të veçanta të kërkimit shkencor

1. Personeli i instituteve dhe i njësive të veçanta të kërkimit shkencor përbëhet nga punonjës kërkimorë-shkencorë, punonjës ndihmësteknikë dhe administrativë. Rregullimi i marrëdhënieve të punësimit ndërmjet palëve përcaktohet në kontratën

e punës, e cila nënshkruhet nga drejtuesi i tyre, në përputhje me Kodin e Punës, me kohëzgjatje të caktuar ose të pacaktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.

2. Procedurat e rekrutimit përcaktohen në rregulloret e brendshme të tyre. Për institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor jopublik, personeli kërkimor-shkencor rekrutohet sipas përcaktimeve në statutet dhe në rregulloret e brendshme të tyre.

3. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor kanë të drejtë të punësojnë për periudha të shkurtra kohe kërkues, studiues, personalitete në fushën e shkencës dhe të kërkimit shkencor, vendas ose të huaj. Personeli i ftuar punësohet dhe shpërblehet sipas përcaktimeve në statut, në rregulloren e institutit/njësisë së veçantë dhe në përputhje me legjislacionin e punës në Republikën e Shqipërisë.

4. Niveli i pagës, kategorizimet në pagë dhe shpërblimi për punën në bazë të cilësisë dhe të rëndësisë së rezultateve të kërkimit shkencor, të personelit të instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor publik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi të fushës përkatëse. Për institutet, njësitë e veçanta jopublike të kërkimit shkencor, niveli i pagës dhe kategorizimet në pagë përcaktohen në kontratën e punës ndërmjet palëve.

Neni 24
Të drejtat dhe detyrat e punonjësit kërkimor-shkencor

1. Punonjësi kërkimor-shkencor ka të drejtë:

a) të zgjedhë lirshëm drejtimin dhe metodën e kërkimit shkencor sipas synimeve të tij shkencore, si dhe në funksion e në përputhje me veprimtarinë dhe misionin e institutit ose të njësisë së veçantë pranë të cilit është i punësuar;

b) të marrë pjesë në formimin e kërkuesve dhe të specialistëve të lartë për fushën përkatëse nëpërmjet aktivitetit të mësimdhënies në të gjitha ciklet e studimit, si dhe udhëheqjeve në ciklin e dytë ose të tretë, në përputhje me kriteret e akteve nënligjore përkatëse;

c) të ketë mbështetjen e nevojshme financiare për realizimin e planit të punës kërkimore-shkencore dhe promovimin e tij në karrierë;

ç) të ketë kushtet e duhura logjistike dhe të punës në kryerjen e veprimtarisë së tij kërkimore-shkencore;

d) të marrë pjesë në kurse kualifikimi, shkëmbim përvoje ose veprimtari kërkimore-shkencore pranë institucioneve homologe dhe të tjera të ngjashme brenda ose jashtë vendit;

dh) të vlerësohet dhe të shpërblehet për punën e tij në bazë të cilësisë dhe të rëndësisë së rezultateve, në kuadër të pjesëmarrjes në veprimtari dhe në projekte të kërkimit shkencor;

e) të publikojë rezultatet e punës së tij kërkimore;

ë) të gëzojë të drejtat e tij intelektuale të rezultateve dhe të botimeve të tij, sipas legjislacionit përkatës e parashikimeve kontraktore me institucionin ku është punësuar.

2. Punonjësi kërkimor-shkencor ka detyrimin:

a) të zbatojë statutin dhe rregulloren e institucionit kërkimor-shkencor;

b) të respektojë kodin e etikës;

c) të zbatojë programin e veprimtarisë kërkimore-shkencore;

ç) të respektojë parimet e shkencës së hapur;

d) të ndjekë programet e detyrueshme të kualifikimit të përcaktuara me aktet e brendshme të institucionit të kërkimit shkencor.

3. Të drejtat dhe detyrimet e tjera të punonjësve përcaktohen në statutin dhe aktet përkatëse të institucionit në përputhje me këtë ligj.

Neni 25
Kategoritë e punonjësve kërkimorë-shkencorë dhe kriteret për fitimin e kategorive

1.Punonjësit kërkimorë-shkencorë klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

a) asistent kërkues-shkencor;

b) kërkues shkencor;

c) kërkues shkencor i avancuar;

ç) drejtues kërkimor-shkencor.

2. Kriteret dhe procedurat për përfitimin e kategorisë nga punonjësit kërkimorë-shkencorë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 26
Titulli "shkencëtar emeritus"

1. Institutet e kërkimit shkencor të krijuara sipas këtij ligji akordojnë titullin "shkencëtar emeritus" për punonjësit e kategorisë "drejtues kërkimor-

shkencor" pas daljes në pension, në bazë të vlerësimit të veprimtarisë tyre të spikatur kërkimore-shkencore nga instituti që propozon dhënien e titullit, pas marrjes së pëlqimit nga ministri.

2. "Shkencëtari emeritus", sipas nevojave të institutit apo të njësisë së veçantë kërkimore-shkencore, mund të marrë pjesë në veprimtari të kërkimit shkencor.

3. Institucionet e kërkimit shkencor, që organizohen dhe funksionojnë sipas ligjeve të posaçme, akordojnë tituj sipas përcaktimeve në ligjin e krijimit.

Neni 27
Lëvizshmëria e punonjësit kërkimor-shkencor

1. Punonjësi kërkimor-shkencor, në kuadër të një projekti apo marrëveshjeje bashkëpunimi, mund të ushtrojë veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore jashtë vendit për një periudhe kohore të caktuar. Kriteret, rregullat e kohëzgjatjes së periudhës së qëndrimit, marrëdhëniet administrative dhe raportet e punonjësit me institucionin ku do të angazhohet përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve, bazuar në aktet e brendshme të institutit apo të njësisë së veçantë ku është punësuar.

2. Punonjësi kërkimor-shkencor i huaj mund të ushtrojë veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore pranë një institucioni të krijuar me ligj të posaçëm, instituti apo njësie të veçantë kërkimore-shkencore, në kuadër të një projekti apo marrëveshjeje bashkëpunimi, për një periudhë të caktuar kohe, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të tyre.

Neni 28
Periudha sabatike

1. Punonjësi kërkimor-shkencor ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institutit apo të njësisë së veçantë kërkimore-shkencore, për përparimin e tij profesional, një herë në 7 (shtatë) vjet, për periudha kohe deri në 1 (një) vit kalendarik.

2. Miratimi i periudhës sabatike bëhet nga titullari i institutit apo i njësisë së veçantë. Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të periudhës sabatike përcaktohen në statut dhe në rregulloret e brendshme.

Neni 29
Vlerësimi i veprimtarisë së punonjësit kërkimor-shkencor

1. Rezultatet e veprimtarisë së punonjësit kërkimor-shkencor vlerësohen në vazhdimësi në mënyrë periodike në institutin apo në njësinë e veçantë kërkimore-shkencore, ku ushtron aktivitetin, prej strukturave të ngritura për këtë qëllim.

2. Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të punonjësit kërkimor-shkencor përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU VI
INTEGRITETI NË SHKENCË DHE NË KËRKIMIN SHKENCOR

Neni 30
Kodi i Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor

1. Kodi i Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor është dokumenti kryesor për garantimin e vlerave të kërkimit shkencor për të gjitha institutet apo njësitë e veçanta kërkimore-shkencore, ku kryhet veprimtari kërkimore-shkencore. Ky kod miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kodi i Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor përmban:

a) parimet themelore të etikës në shkencë dhe kërkim;

b) praktikat e mira të shkencës dhe të kërkimit;

c) llojet e shkeljeve dhe të masave disiplinore, si dhe procedurat për dhënien e tyre në rastin e shkeljeve të etikës në shkencë dhe në kërkim;

ç) risqet dhe sistemin e menaxhimit të tyre në shkencë dhe në kërkim shkencor.

3. Çdo institut apo njësi e veçantë kërkimore-shkencore respekton Kodin e Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor duke përcaktuar procedurat specifike në zbatim të tij.

Neni 31
Komiteti i Etikës në Kërkimin Shkencor

1. Komiteti i Etikës ngrihet pranë instituteve apo njësive të veçanta kërkimore-shkencore të parashikuara në këtë ligj dhe vepron në bazë të Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkim

Shkencor, dhe rregulloreve përkatëse të miratuara nga vetë ato. Në përbërje të tij mund të përfshihen edhe ekspertë të jashtëm, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloret e tyre.

2. Komiteti i Etikës vlerëson plotësimin e kritereve për shmangien e riskut në kërkimin shkencor në përputhje me Kodin e Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor. Risku i kërkimit vlerësohet në çdo projekt kërkimor dhe ndryshim të tij për veprimtaritë dhe produktin e kërkimit shkencor.

3. Komiteti i Etikës propozon masat disiplinore sipas parashikimeve të dispozitave të këtij ligji.

4. Përbërja dhe funksionimi i Komitetit të Etikës rregullohet me aktet e brendshme të institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

Neni 32
Shkeljet dhe masat disiplinore në kërkimin shkencor

1. Plagjiatura, falsifikimi dhe fabrikimi i rezultateve të kërkimit shkencor përbëjnë shkelje të rënda të etikës në kërkimin shkencor.

2. Masat këshilluese dhe ato disiplinore ndaj punonjësve që shkelin etikën në kërkim shkencor, propozohen nga Komiteti i Etikës dhe jepen nga titullari i institutit apo i njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, bazuar në Kodin e Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor.

3. Masa disiplinore më e rëndë është shfuqizimi i kategorisë së punonjësit të kërkimit shkencor, e cila jepet vetëm për shkelje të rënda të etikës së kërkimit shkencor.

4. Punonjësi kërkimor-shkencor, të cilit i është shfuqizuar kategoria, mund të aplikojë për të njëjtën kategori pas kalimit të 3 (tre) vjetëve nga akti i shfuqizimit.

KREU VII
FINANCIMI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Neni 33
Burimet e financimit

1. Institucionet e arsimit të lartë, institucionet e krijuara me akte të posaçme, institutet/njësitë e veçanta, qendrat e ekselencës dhe njësitë e posaçme të kërkimit shkencor financohen me fonde nga:

a) buxheti i shtetit;

b) projektet ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit;

c) të ardhura nga veprimtari të kërkimit shkencor dhe inovacionit;

ç) të ardhura nga shërbime tekniko-shkencore për të tretët;

d) të drejtat e pronësisë intelektuale, si: patentat, shpikjet, veprat e ndryshme etj.;

dh) të ardhura nga aplikimi në praktikë i rezultateve të veprimtarisë kërkimore dhe inovacionit nga institutet e njësitë e veçanta të kërkimit shkencor;

e) dhurime nga donatorë të ndryshëm;

ë) burime ose veprimtari të tjera të ligjshme.

2. Institucionet e arsimit të lartë, institucionet e krijuara me akte të posaçme, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor janë të detyruara të sigurojnë një përdorim sa më efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë.

3. Burimet financiare të vëna në dispozicion të institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve të krijuara me akte të posaçme, instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor, nga organizma jopublikë ose ndërkombëtarë, përdoren vetëm për përmbushjen e misionit dhe të objektivave të tyre.

4. Për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera publike, të cilat aktualisht ushtrojnë veprimtari në fushën e kërkimit shkencor dhe organizohen me ligj të veçantë, burimet e financimit rregullohen sipas ligjit përkatës dhe përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 34
Mënyrat e financimit për institucionet publike të kërkimit shkencor

1. Mënyra e financimit nga buxheti i shtetit dhe kategorizimi i fondeve buxhetore për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera publike, të cilat aktualisht ushtrojnë veprimtari në fushën e kërkimit shkencor, përcaktohet sipas legjislacioneve specifike të fushave ku ushtrojnë veprimtarinë dhe përcaktimeve të këtij ligji. Institucionet e krijuara me ligj të veçantë financohen sipas përcaktimeve në ligjin e krijimit.

2. Burimet financiare për veprimtarinë e kërkimit shkencor për institucionet, institutet dhe njësitë e

veçanta publike të kërkimit shkencor, planifikohen, miratohen, administrohen, pasqyrohen dhe raportohen sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Neni 35
Financimi për programet apo projektet kërkimore

Institucionet e arsimit të lartë, institucionet e krijuara me ligj të posaçëm, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, publike dhe jopublike, financohen mbi baza konkurruese të programeve apo të projekteve kërkimore që paraqesin për financim pranë ministrisë apo institucionit përgjegjës të varësisë, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Për përdorimin e fondeve publike ato i nënshtrohen auditimit financiar.

Neni 36
Bashkëfinancimi i projekteve kërkimore

1. Institucionet e arsimit të lartë, institucionet e krijuara me ligj të posaçëm, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor për projekte kërkimore të veçanta mund të financohen nga fonde të krijuara nga bashkimi i dy ose më shumë burimeve të mëposhtme:

a) buxheti i shtetit;

b) financime të ligjshme nga subjekte jopublike;

c) financime të ligjshme nga institucione ndërkombëtare.

2. Masa dhe mënyra e financimit rregullohen në marrëveshjen dypalëshe ose shumëpalëshe, që lidhin institucionet dhe njësitë e kërkimit shkencor.

Neni 37
Administrimi i aseteve

1. Institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor kanë në administrim ose në pronësi godinat ku zhvillojnë aktivitetin, pajisjet, revistën, bibliotekën, muzeun, si dhe produkte të krijimtarisë intelektuale. Këto institucione gjatë aktivitetit të tyre krijojnë apo zhvillojnë asete financiare apo fizike nëpërmjet burimeve të ligjshme të financimit.

2. Pronat e paluajtshme në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre institutet dhe njësitë e veçanta publike të kërkimit shkencor, që shërbejnë për të garantuar përmbushjen e misionit të institucionit, kalojnë në administrim të tij me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Institutet dhe njësitë e veçanta publike të kërkimit shkencor kanë detyrimin të ruajnë dhe të mirëmbajnë pronat në administrim dhe nuk mund të ndryshojnë destinacionin e tyre.

KREU VIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 38
Dispozita kalimtare

1. Të gjitha institucionet, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë detyrimin ta depozitojnë informacionin dhe dokumentacionin në përputhje me elementet e Regjistrit Kombëtar të Institucioneve dhe Kërkuesve Shkencorë brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Vlerësimi i parë i instituteve apo i njësive të veçanta të kërkimit shkencor ekzistues, duke përjashtuar institucionet e arsimit të lartë, të cilat vlerësohen sipas ligjit të arsimit të lartë, bëhet brenda 3 (tre) vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Aktet nënligjore të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të do të zbatohen deri sa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj.

Neni 39
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 6; 8, pika 2; 10, pika 5; 16, pika 4; 18, pika 3; 19, pika 3; 20, pika 2; 21, pika 1; 22, pika 1; 23, pika 4; 25, pika 2, dhe 30, pika 1, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor që brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 2; 29, pika 2, dhe 35 të këtij ligji.

Neni 40
Shfuqizime

Ligji nr. 7893, datë 22.12.1994, "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 41
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.10.2024.

Shpallur me dekretin nr. 394, datë 25.11.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 394, datë 25.11.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 75, datë 28.10.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 28.10.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr. 14 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Avenir Ballvora

SUBJEKT I INTERESUAR: Shaqir Shtishi

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 10342, datë 28.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; pikës 2 të vendimit nr. 212, datë 29.1.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimit nr. 00-2023-4924(683), datë 22.11.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 5, 18, 41, 42, 44, 131, shkronja "f", 134, shkronja "i" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Avenir Ballvora *(kërkuesi),* i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar Shaqir Shtishi, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Trashëgimlënësja Haxhire Ballvora është bërë pronare e vetme e një shtëpie banimi, të ndodhur në Tiranë, bazuar në kontratën e dhurimit të vitit 1987, me të cilën dy motrat e saj Sulltane Merja (Ballvora) dhe Fatmira Ballvora, i kanë kaluar asaj pjesët takuese. Dy motrat e trashëgimlënëses e kanë rikonfirmuar vullnetin e dhurimit edhe në deklaratën noteriale të vitit 2002.

2. Pronësia e të tria motrave mbi shtëpinë ishte fituar me trashëgimi ligjore prej të atit të tyre, si dhe prej kalimit të pjesës takuese të trashëgimtarit të katërt ligjor (vëllait të tyre, i cili është i ati i kërkuesit) në favor të të tria motrave kundrejt shpërblimit në para.

3. Me dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7678, datë 19.7.2012, është përcaktuar se motra Fatmira Ballvora ka ndërruar jetë në datën 15.3.2012 dhe se trashëgimtari i vetëm testamentar i saj është kërkuesi, i cili ka përfituar të gjithë pasurinë trashëgimore, me përjashtim të gardërobës personale që iu është nënshtruar rregullave të trashëgimisë ligjore.

4. Në vitin 1992 trashëgimlënësja Haxhire Ballvora e ka dhuruar shtëpinë në favor të shtetasit Hajdar Qufaj (*dhurimi i parë*). Ky i fundit, në vitin 1996, ia ka dhuruar shtëpinë shtetasit Vasil Nishku (*dhurimi i dytë*). Në veprimin juridik të dhurimit të dytë, dhuruesi Hajdar Qufaj është përfaqësuar nga kërkuesi. Në vitin 1998 shtetasi Vasil Nishku ia ka dhuruar shtëpinë kërkuesit (*dhurimi i tretë*). Aktet e dhurimit janë regjistruar me radhë dhe në vitin 1998 shtëpia është regjistruar në emër të kërkuesit. Bashkëshortja e kërkuesit në vitin 2000 ka marrë një kredi bankare dhe shtëpia e banimit është vendosur në hipotekë për sigurimin e kthimit të kredisë.

5. Në datën 5.5.2000, trashëgimlënësja Haxhire Ballvora ka përpiluar testament, me të cilin ka disponuar kalimin e shtëpisë në favor vetëm të trashëgimtarit testamentar, subjektit të interesuar, Shaqir Shtishi. Trashëgimlënësja ka ndërruar jetë në datën 10.6.2003. Testamenti është çelur dhe mbi bazën e dëshmisë së trashëgimisë testamentare të lëshuar nga gjykata e shkallës së parë në vitin 2004, shtëpia është regjistruar në pronësi të subjektit të interesuar, Shaqir Shtishi, në datën 23.12.2004.

6. E drejta e pronësisë mbi shtëpinë e banimit është bërë objekt gjykimi në pesë procese gjyqësore, të përshkruara në vijim.

i. Procesi gjyqësor për pavlefshmërinë e dhurimit të parë

7. Në vitin 1996 trashëgimlënësja Haxhire Ballvora ka ngritur padi në gjykatë, me objekt deklarimin të pavlefshme të kontratës së dhurimit të vitit 1992, me të cilën shtëpia kishte kaluar në pronësi të shtetasit Hajdar Qufaj. Me vendimin nr. 1517, datë 5.3.1996, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë. Vendimi është bërë përfundimtar, pasi nuk është ankimuar nga asnjë prej palëve. Në datën 18.4.1996 pasuria është regjistruar në emër të trashëgimlënëses Haxhire Ballvora.

ii. Procesi gjyqësor për pavlefshmërinë e dhurimit të dytë dhe të tretë

8. Trashëgimlënësja Haxhire Ballvora ka ngritur sërish padi në gjykatë, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të të dyja kontratave të dhurimit: i. dhurimit të dytë të vitit 1996, me të cilin prona kishte kaluar te shtetasi Vasil Nishku; ii. dhurimit të tretë të vitit 1998, me të cilin prona kishte kaluar te kërkuesi. Po kështu, trashëgimlënësja ka kërkuar edhe fshirjen e regjistrimeve të këtyre kontratave. Në ngritjen e padisë trashëgimlënësja ka parashtruar si shkak veprimet e kryera në mashtrim të ligjit, me argumentin se kërkuesi ka pasur dijeni për pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit të parë dhe të drejtën e pronësisë së trashëgimlënëses, megjithatë ai ka përfaqësuar dhuruesin Hajdar Qufaj në kontratën e dhurimit të dytë të vitit 1996, si dhe ka përfituar për vete pasurinë me anë të kontratës së dhurimit të tretë në vitin 1998.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4157, datë 26.12.2000, ka vendosur rrëzimin e padisë. Vendimi është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 705, datë 7.6.2001, ka vendosur konstatimin të pavlefshme të kontratave të dhurimit të dytë dhe të tretë, të lidhura respektivisht në vitet 1996 dhe 1998, duke urdhëruar edhe fshirjen nga regjistri hipotekar të pasurisë në emër të kërkuesit. Gjykata e apelit ka arsyetuar se kontrata e dytë e dhurimit e vitit 1996 është bërë pasi kontrata e dhurimit të parë e vitit 1992 ishte deklaruar e pavlefshme me vendim gjyqësor përfundimtar dhe se dhurimi është bërë nga përfaqësuesi i pronarit, konkretisht kërkuesi, pa pasur tagra për një veprim të tillë juridik. Për këto dy shkaqe edhe kontrata e tretë e dhurimit e vitit 1998 ishte e pavlefshme. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 622, datë 24.5.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit. Në këto rrethana, me përfundimin e këtij procesi gjyqësor, shtëpia ka mbetur në pronësi të trashëgimlënëses Haxhire Ballvora.

iii. Procesi gjyqësor për regjistrimin e truallit të shtëpisë

10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4994, datë 25.10.2004, ka vendosur pranimin e padisë së trashëgimtarit Shaqir Shtishi, duke detyruar Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*), Tiranë të regjistrojë në favor të tij sipërfaqen e truallit prej 225 m^2, që është trualli mbi të cilin është ndërtuar shtëpia dhe e gjithë pasuria (shtëpia dhe trualli) është fituar prej tij me trashëgimi testamentare. Vendimi

nuk është ankimuar nga asnjë prej palëve, ndaj është bërë përfundimtar dhe i ekzekutueshëm.

iv. Procesi gjyqësor për kundërshtimin e testamentit nga një prej motrave të trashëgimlënëses

11. Në vitin 2005 Sulltane Merja (Ballvora), në cilësinë e motrës së trashëgimlënëses Haxhire Ballvora, ka paraqitur padi në gjykatë, me objekt kundërshtimin e testamentit, me pretendimin se ishte cenuar rezerva ligjore, duke mos disponuar në favor të saj, pasi ishte e paaftë për punë. Kjo kërkesëpadi është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 3570, datë 14.5.2007, e cila ka arsyetuar se rezerva ligjore nuk rezultonte të ishte prekur, pasi paditësja nuk kishte jetuar me testatoren të paktën një vit përpara vdekjes së saj.

12. Mbi bazën e apelit të paditëses, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 918, datë 9.5.2008, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, me arsyetimin se nuk ishte hetuar mosmarrëveshja dhe shkaku ligjor i saj, në kushtet kur padia kishte në objektin e saj kundërshtimin e testamentit, bazuar në nenet 360 e vijues të Kodit Civil *(KC)* dhe se gjykata e shkallës së parë mund të kishte hetuar lidhjen gjinore të përfituesit të testamentit me trashëgimlënësen për të konstatuar edhe kryesisht nëse veprimi juridik ishte ose jo nul.

13. Mbi bazën e rekurseve të paraqitura nga të dyja palët, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 372, datë 15.9.2011, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, duke arsyetuar se hetimi i plotë gjyqësor përmes marrjes së provave të reja mund të përsëritej me nismën e vetë gjykatës së apelit.

14. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 140, datë 24.1.2012, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit për rrëzimin e padisë, me të njëjtin arsyetim, duke vënë në dukje se paditësja gjatë gjykimit në shkallë të parë nuk kishte pretenduar shkaqe të tjera për pavlefshmërinë e testamentit, përveç rezervës ligjore.

15. Paditësja Sulltane Merja (Ballvora) ka paraqitur sërish rekurs, por Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 761, datë 11.4.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit të paditëses, me arsyetimin se ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon ligji.

v. Procesi gjyqësor për kundërshtimin e testamentit nga kërkuesi

16. Në datën 31.10.2013, kërkuesi ka paraqitur padi në gjykatën e rrethit, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së testamentit të trashëgimlënëses Haxhire Ballvora (emta e tij) në favor të subjektit të interesuar Shaqir Shtishi. Me të njëjtën padi kërkuesi ka kërkuar detyrimin e subjektit të interesuar ta njihte pronar të vetëm të shtëpisë, si dhe ta shpërblente për përdorimin e saj nga data 23.12.2004 deri në ngritjen e padisë. Në ngritjen e padisë kërkuesi ka parashtruar si shkaqe: i. subjekti i interesuar Shaqir Shtishi nuk përfshihet në rrethin e trashëgimtarëve; ii. kërkuesi ka banuar në fakt në shtëpinë, objekt të testamentit, deri në kohën që është larguar në SHBA; iii. kërkuesi është trashëgimtar i shtetases Fatmira Ballvora, motra e trashëgimlënëses Haxhire Ballvora; iv. testamenti është i pavlefshëm, pasi në kohën e hartimit të tij trashëgimlënësja nuk ka qenë pronare e shtëpisë; v. testamenti ka cenuar rezervën ligjore të motrës së trashëgimlënëses, shtetases Fatmira Ballvora, e cila ishte person i paaftë për punë në ngarkim të Haxhire Ballvorës; vi. subjekti i interesuar Shaqir Shtishi, e ka poseduar shtëpinë në kundërshtim me ligjin, ndaj duhet t'ia kthejë kërkuesit dhe ta paguajë për përdorimin e saj.

17. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10342, datë 28.10.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Në vendimin e saj gjykata ka arsyetuar se është i pabazuar pretendimi se trashëgimlënësja Haxhire Ballvora ka disponuar me testament një send që nuk ishte në pronësinë e saj, pasi të tria kontratat e dhurimit të viteve 1994, 1996 dhe 1998 janë konstatuar të pavlefshme me vendime gjyqësore përfundimtare. Sipas saj, edhe pse shtëpia është regjistruar në vitin 1998 në emër të kërkuesit, regjistrimi i pronës jo vetëm që nuk krijon pasoja juridike, por me vendim gjyqësor përfundimtar është urdhëruar edhe fshirja nga regjistri hipotekar. Lidhur me kërkimin për pavlefshmërinë e testamentit, gjykata ka arritur në përfundimin se përfituesi i testamentit, subjekti i interesuar, Shaqir Shtishi, përfshihet në rrethin e trashëgimtarëve (gjyshi i tij kishte motër trashëgimlënësen), ndaj trashëgimlënësja nuk ka disponuar me testament jashtë radhëve të tyre, ndërsa për sa i takon rezervës ligjore nuk provohet se e ndjera Fatmira Ballvora të ketë qenë person në ngarkim të trashëgimlënëses, ndaj nuk konsiderohet si trashëgimtare e saj brenda konceptit të personit të paaftë për punë.

18. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 212, datë 29.1.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit, duke konstatuar të pavlefshëm testamentin e testatores Haxhire Ballvora, si dhe duke prishur vendimin dhe pushuar gjykimin për kërkimet me objekt njohjen pronar dhe shpërblimin e dëmit për përdorimin e sendit. Gjykata e apelit ka arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të KC-së, lidhur me dispozitat për trashëgiminë. Sipas saj, subjekti i interesuar, Shaqir Shtishi, është jashtë radhëve të trashëgimisë ligjore; trashëgimlënësi ka liri të kufizuar për të disponuar me testament; ai mund të disponojë në favor të personave jashtë radhëve të trashëgimtarëve ligjorë vetëm nëse nuk ka trashëgimtarë ligjorë të tri radhëve të para; në rastin konkret, motra e trashëgimlënëses, shtetasja Fatmira Ballvora, ka qenë e gjallë në kohën e çeljes dhe hartimit të testamentit, fakt që e ndalonte atë të disponontе në favor të të tretëve, siç ka ndodhur, ndaj testamenti, bazuar në nenet 405–406 të KC-së, është i pavlefshëm. Ndërsa gjykimi i kërkimeve të tjera (për njohjen e pronësisë dhe shpërblimin e dëmit) nuk mund të vazhdojë, sepse nuk mund të ngrihen në këtë fazë gjykimi, ndaj duhet pushuar.

19. Mbi rekursin e subjektit të interesuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, fillimisht, me vendimin nr. 157, datë 24.3.2016, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Pas shqyrtimit të rekursit, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4924(683), datë 22.11.2023, ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe pushimin e gjykimit për kërkimin që lidhej me pavlefshmërinë e testamentit, si dhe lënien në fuqi të pjesës tjetër të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, që disponontе pushimin e gjykimit për kërkimet për njohjen e pronësisë dhe shpërblimin e dëmit nga përdorimi i sendit. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykatat e faktit nuk kanë interpretuar drejt parimin e gjësë së gjykuar. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat kanë dhënë vendim përfundimtar mbi bazën e padisë së Sulltane Merjas (Ballvora), duke zgjidhur përfundimisht vlefshmërinë e testamentit konform nenit 377 të KC-së, ndaj ky pretendim nuk mund të ngrihet më nga asnjë palë që pretendon të drejta nga trashëgimlënësja lidhur me testamentin objekt gjykimi. Për këtë arsye, kërkuesi nuk legjitimohej t'i drejtohej gjykatës. Ndërsa lidhur me pjesën tjetër të vendimit që është lënë në fuqi, Gjykata e Lartë është mjaftuar me arsyetimin se ajo pjesë e vendimit është e drejtë. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se duhej revokuar edhe vendimi për pezullimin e ekzekutimit të vendimit.

20. Në datën 12.4.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/200, është regjistruar në datën 18.4.2024. Në datën 17.5.2024, kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës me kërkesë shtesë, në të cilën ka ngritur pretendime ndaj mendimit të gjyqtarit në pakicë që shoqëron vendimin e Gjykatës së Lartë, të kundërshtuar prej tij.

21. Në datën 24.6.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Gjatë procedurës së njoftimeve për përgatitjen e çështjes për gjykim, kërkuesi në datat 30.8.2024 dhe 13.9.2024, ka kërkuar përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së tij. Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 23.9.2024, vendosi rrëzimin e saj me arsyetimin se duke mbajtur në konsideratë datën e regjistrimit të çështjes, rezultonte se ajo ishte në radhë kronologjike për t'u shqyrtuar në një kohë të shpejtë dhe se kërkesa për përshpejtim nuk shoqërohej nga argumente kushtetuese.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

22. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara i janë cenuar:

22.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

22.1.1 *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi Gjykata e Lartë ka pushuar gjykimin për kërkimin për pavlefshmërinë absolute të testamentit, duke arsyetuar se ky kërkim është *gjë e gjykuar* në raport me procesin e katërt gjyqësor. Konkluzioni është i pasaktë, pasi procesi për pavlefshmërinë e testamentit, i vënë në lëvizje nga motra e trashëgimlënëses Sulltane Merja (Ballvora), është i ndryshëm nga procesi gjyqësor për pavlefshmërinë e testamentit i vënë në lëvizje nga kërkuesi. Procesi i mëparshëm, siç është shprehur edhe vetë gjykata e apelit në atë rast, nuk e ka zgjidhur në themel pavlefshmërinë e testamentit, por i ka dhënë zgjidhje vetëm çështjes së rezervës ligjore të trashëgimtares

Sulltane Merja (Ballvora). Ndryshimet midis dy proceseve gjyqësore lidhen me palët, objektin dhe bazën ligjore, si dhe shkakun ligjor të padive në dy proceset gjyqësore. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është alogjik, me të meta dhe kopje e pasaktë e një vendimi tjetër të mëparshëm të saj, në kushtet kur ky i fundit nuk është as vendim unifikues. Gjykata e Lartë ka keqinterpretuar doktrinën *estopel* dhe rregullin *Henderson*, pjesë të sistemit juridik *common law*, që ndalojnë rishqyrtimin gjyqësor të një pretendimi ose çështjeje specifike, të lidhur me një provë ose fakt, që është zgjidhur përfundimisht brenda një procesi gjyqësor. Për pasojë, kërkuesi është privuar nga një proces i rregullt dhe i drejtë nëpërmjet garantimit të një hetimit të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin, duke i mohuar atij të drejtën e gjykimit të thelbit të pretendimeve.

22.1.2 *Barazisë së armëve,* pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë administruar dhe vlerësuar provat e paraqitura nga ana e kërkuesit, në mënyrë të veçantë gjykata e apelit nuk ka vlerësuar si provë deklaratën noteriale të vitit 2002 të trashëgimlënëses Haxhire Ballvorës, të regjistruar edhe në ZVRPP, me të cilën ajo deklaron se nuk ka kryer asnjë veprim noterial ose akt tjetër që parashikon KC-ja për kalimin e pronësisë te persona të tretë. Ky akt noterial provon se testamenti i vitit 2000 nuk ekziston.

22.1.3 *Së drejtës për gjykim të drejtë dhe publik*, pasi në kundërshtim me standardet e vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, mendimi i gjyqtarit në pakicë nuk i është njoftuar dhe dorëzuar kërkuesit kur ka tërhequr kopjen e vendimit të Gjykatës së Lartë. Vendimi i Gjykatës së Lartë është shkruar në mënyrë të tillë që të lë të kuptosh se ka qenë unanim dhe mendimi i gjyqtarit në pakicë nuk është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë së bashku me vendimin. Mendimi i pakicës nuk është koherent në konkluzionet e tij, duke cenuar të drejtën për proces të rregullt. Ai është kontradiktor, sepse shprehet për kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit, duke u vijuar më tej se çështja duhej pezulluar derisa Gjykata të vendoste për kushtetutshmërinë e nenit 377 të KC-së. Mendimi për rikthimin e çështjes për rigjykim cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të kohëzgjatjes, sepse çështja ishte pezulluar në Gjykatën e Lartë prej 8 vjetësh.

22.1.4 *Së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm*, pasi procesi ka zgjatur mbi 11 vjet, në veçanti në Gjykatën e Lartë ka zgjatur 8 vjet, ndonëse kërkuesi ka paraqitur rreth 20 kërkesa me shkrim për përshpejtimin e tij. Në praktikën gjyqësore nuk ka një rast ku vendimi i pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të rrijë 8 vjet në fuqi, kohëzgjatje që ka sjellë pasoja të pariparueshme, siç është shembja e banesës nga Bashkia Tiranë, detyrimin e kërkuesit të jetojë me qira, ndërsa përfituesi i testamentit të përfitojë kredi bankare prej 5.5 milionë lekësh, duke vënë shtëpinë si kolateral. Për shkak të këtyre rrethanave, kërkuesit i është cenuar edhe e drejta për një mjet efektiv për të parandaluar shkeljet e të drejtave themelore, që i garantohen nga neni 13 i KEDNJ-së.

22.2 *E drejta e pronës,* e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi gjykatat e zakonshme nëpërmjet procesit të parregullt ligjor që kanë zhvilluar i kanë mohuar kërkuesit pronësinë mbi shtëpinë.

23. ***Subjekti i interesuar, Shaqir Shtishi***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

23.1 Pretendimet e kërkuesit që lidhen me vendimin e gjykatës së apelit nuk duhet të pranohen, sepse ai nuk ka paraqitur rekurs ndaj tij. Çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Lartë bazuar në rekursin e subjektit të interesuar.

23.2 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit nga Gjykata e Lartë nuk qëndron, sepse kjo e fundit ka interpretuar saktë ligjin procedural për gjënë e gjykuar mbi faktet e mosmarrëveshjes, duke e pushuar me të drejtë gjykimin. Ankimi i kërkuesit synon të lërë pa fuqi gjënë e gjykuar, ndaj përbën abuzim me të drejtën, shkel rëndë parimin e sigurisë juridike, si dhe kërcënon shtetin e së drejtës. Pretendimet e kërkuesit synojnë të diskreditojnë veprimet ligjore të lidhura me të drejtën e pronës ndaj pasurisë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

24. Çështja e legjitimimit *(locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi

gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

25. Në rastin në shqyrtim, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

26. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete *(shih vendimet nr. 31, datë 29.5.2023; nr. 15, datë 11.3.2021; nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit, me pretendimin se ai është rrjedhojë e mosrespektimit të parimit të barazisë së armëve. Sipas kërkuesit, gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar dhe vlerësuar deklaratën noteriale të lëshuar nga trashëgimlënësja Haxhire Ballvora në vitin 2002, me të cilën provohej se testamenti i vitit 2000 nuk ka ekzistuar. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi nuk ka paraqitur rekurs ndaj vendimit të gjykatës së apelit, çmon se pretendimet e tij ndaj vendimit të gjykatës së apelit, ashtu siç me të drejtë prapëson subjekti i interesuar, nuk mund të merren në shqyrtim për shkak se nuk janë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

28. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, me argumentin se procesi gjyqësor i tij ka zgjatur mbi 11 vjet, prej të cilave 8 vjet në Gjykatën e Lartë, pavarësisht se ai ka paraqitur rreth 20 kërkesa me shkrim në atë gjykatë për përshpejtimin e procedurës. Nga shqyrtimi i akteve që kërkuesi i ka bashkëlidhur ankimit të tij dhe akteve të dosjes gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se në to nuk gjendet ndonjë kërkesë drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procesit bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Për këto të fundit, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se janë mjete juridike që ofrojnë rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese dhe vetëm pasi t'i ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen prej tyre nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, individi mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, për pasojë pretendimi i tij për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk mund të merret në shqyrtim.

29. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

30. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Duke zbatuar këtë standard, në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë mban datën 22.11.2023 dhe është bërë i disponueshëm për palët në datën 1.3.2024, kur është publikuar në faqen zyrtare të saj, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 12.4.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

32. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik, duke e lidhur këtë pretendim me mendimin e gjyqtarit në pakicë, që i është bashkëngjitur vendimit të kundërshtuar prej tij. Sipas kërkuesit, mendimi i pakicës nuk i është njoftuar rregullisht atij dhe nuk është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, ndërsa në përmbajtje ai është kontradiktor

dhe jokoherent. Për sa i takon këtij pretendimi, Gjykata, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, vë në dukje se objekt i gjykimit kushtetues janë vendimet gjyqësore dhe jo mendimet e pakicës, pasi këto të fundit nuk sjellin pasoja ndaj të drejtave kushtetuese, por i shërbejnë transparencës së veprimtarisë së gjykatave. Akti i cili është i ekzekutueshëm dhe për pasojë prek të drejtat kushtetuese të individit është në çdo rast vendimi gjyqësor dhe jo mendimi i pakicës. Për rrjedhojë, mendimi i pakicës nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues, ndaj Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe publik për shkak të mendimit të pakicës nuk mund të merret në shqyrtim *ratione materiae*.

33. Në vijim, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar edhe *cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, për shkak të interpretimit që Gjykata e Lartë i ka bërë konceptit të gjësë së gjykuar, me pasojë pushimin e gjykimit. Po kështu, ai ka pretenduar se i është cenuar edhe *e drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi nëpërmjet procesit të parregullt që ka zhvilluar Gjykata e Lartë, atij i është mohuar pronësia mbi shtëpinë. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me pushimin e gjykimit nga Gjykata e Lartë, për shkak të arsyetimit prej saj të konceptit të gjësë së gjykuar, çmon ta trajtojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën që çështja e tij të shqyrtohet nga gjykata. Për rrjedhojë, Gjykata do të analizojë në vijim nëse kërkuesit i është respektuar e drejta e aksesit në gjykatë e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

34. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka pushuar gjykimin për kërkimin për pavlefshmërinë absolute të testamentit dhe i ka mohuar të drejtën e gjykimit të thelbit të pretendimeve për pronësinë e shtëpisë, duke arsyetuar se kërkimi i tij ishte gjë e gjykuar. Sipas tij, konkluzioni i Gjykatës së Lartë është i pasaktë, pasi bëhet fjalë për dy procese gjyqësore të ndryshme, në drejtim të palëve, objektit dhe bazës ligjore, si dhe shkakut ligjor të padive në dy proceset gjyqësore. Gjithashtu, kërkuesi ka parashtruar se arsyetimi i Gjykatës së Lartë është alogjik, me të meta dhe kopje e pasaktë e një vendimi tjetër të mëparshëm të saj, në kushtet kur ky i fundit nuk është as vendim unifikues.

35. Subjekti i interesuar, Shaqir Shtishi, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara. Sipas tij, Gjykata e Lartë ka interpretuar saktë ligjin procedural për gjënë e gjykuar për faktet e mosmarrëveshjes, duke e pushuar me të drejtë gjykimin. Po kështu, sipas tij, ankimi i kërkuesit synon të lërë pa fuqi gjënë e gjykuar, ndaj përbën abuzim me të drejtën, shkel rëndë parimin e sigurisë juridike, kërcënon shtetin e së drejtës dhe synon të diskreditojë veprimet ligjore të lidhura me të drejtën e pronës për shtëpinë.

36. Lidhur me të drejtën e aksesit, Kushtetuta në nenin 42, pika 2, të saj sanksionon të drejtën e individit t'i drejtohet një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tij dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. E drejta e aksesit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 56, datë 25.7.2017; nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Ndërsa për sa i takon arsyetimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e tij si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

38. Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 1, datë*

20.1.2012, të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 7.3.2024; nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 33, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesit ka të bëjë në thelb me faktin që Gjykata e Lartë ka pushuar gjykimin dhe nuk i ka dhënë zgjidhje përfundimtare kërkimit të tij që lidhej me pavlefshmërinë e testamentit, duke arsyetuar se kërkimi ishte gjë e gjykuar më parë, ndaj për t'i dhënë përgjigje pretendimit të tij duhet analizuar nëse interpretimi i gjësë së gjykuar prej Gjykatës së Lartë ka qenë në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit. Me fjalë të tjera, Gjykata do të verifikojë nëse arsyetimi i Gjykatës së Lartë përmban gabime faktike ose ligjore, të cilat nuk janë objektivisht të justifikueshme dhe të arsyeshme.

40. Nën këtë optikë, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë, ndër të tjera, ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe pushimin e gjykimit për kërkimin që lidhej me pavlefshmërinë e testamentit të trashëgimlënëses Haxhire Ballvora, duke arsyetuar se gjykatat e faktit nuk kishin interpretuar drejt parimin e gjësë së gjykuar. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat ishin vënë në lëvizje më parë nga motra e trashëgimlënëses Sulltane Merja (Ballvora) dhe kishin zgjidhur përfundimisht vlefshmërinë e testamentit, konform nenit 377 të KC-së, ndaj asnjë palë që pretendonte të drejta nga trashëgimlënësja lidhur me testamentin nuk mund të ngrinte një kërkim të tillë. Për këtë arsye, sipas Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk legjitimohej t'i drejtohej gjykatës.

41. Duke u ndalur tek të dhënat e dy proceseve gjyqësore, që janë vlerësuar nga Gjykata e Lartë si gjë e gjykuar, Gjykata vë në dukje se procesi gjyqësor, i përfunduar më herët nga gjykatat e zakonshme është vënë në lëvizje nga paditësja Sulltane Merja (Ballvora), me objekt "pavlefshmërinë e testamentit të testatores Haxhire Ballvora", bazuar në nenet 360 e vijues të KC-së, me shkak ligjor cenimin e rezervës ligjore të trashëgimtares Sulltane Merja (Ballvora), e cila ishte e paaftë për punë dhe në ngarkim të trashëgimlënëses. Në ndryshim nga sa parashtron Gjykata e Lartë në vendimin e saj (*shih paragrafin 37 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), as në padinë që ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor, as në shpjegimet shtesë të paraqitura në gjykimin në shkallë të parë nuk është pretenduar se nuk mund të disponohej në favor të të paditurit Shaqir Shtishi.

42. Procesi gjyqësor në shkallë të parë ka përfunduar me vendim për rrëzimin e padisë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2007, e cila ka arsyetuar se rezerva ligjore nuk rezultonte të ishte prekur, pasi trashëgimlënësja Sulltane Merja (Ballvora) nuk kishte jetuar me testatoren të paktën një vit përpara vdekjes së saj. Po sipas gjykatës së shkallës së parë, paditësja nuk ka ngritur ndonjë shkak tjetër për pavlefshmërinë e testamentit dhe në pretendimet përfundimtare ajo është shprehur se nuk kërkonte të bëhej gjyq themeli, por t'i jepej vetëm pjesa që i njihte ligji në bazë të rezervës ligjore (*shih faqen 4 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

43. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë paditësja Sulltane Merja (Ballvora) ka paraqitur apel, duke pretenduar se ishin keqinterpretuar dispozitat ligjore për trashëgiminë, se padia e saj kishte si bazë ligjore të saj nenet 360 e vijues të KC-së, se përfituesi i testamentit Shaqir Shtishi nuk përfshihej në rrethin e trashëgimtarëve, ndaj ishte i pazoti për të trashëguar. Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2008 ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, me arsyetimin se nuk ishte hetuar mosmarrëveshja dhe shkaku ligjor i saj, në kushtet kur padia kishte në objektin e saj kundërshtimin e testamentit, bazuar në nenet 360 e vijues të KC-së. Po kështu, sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë, përpara se të interpretonte nenin 379 të KC-së për rezervën ligjore, mund të kishte hetuar lidhjen gjinore të përfituesit të

testamentit me trashëgimlënësen për të konstatuar edhe *kryesisht* nëse veprimi juridik ishte ose jo nul.

44. Mbi bazën e rekurseve të paraqitura nga të dyja palët, Gjykata e Lartë, në vitin 2011 ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë, duke arsyetuar se nuk vërtetohej asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 467 i KPC-së që të përligjte kthimin e çështjes nga gjykata e apelit në shkallë të parë. Sipas Gjykatës së Lartë, marrja e provës vendimtare, për të provuar lidhjen gjinore mes përfituesit të testamentit dhe testatores nuk ishte e vështirë të bëhej nga gjykata e apelit, ndaj hetimi i plotë gjyqësor përmes marrjes së provave të reja mund të përsëritej me nismën e vetë gjykatës së apelit.

45. Pas rigjykimit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e vitit 2012, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit për rrëzimin e padisë, me arsyetimin se testamenti nuk kishte prekur rezervën ligjore të paditëses Sulltane Merja (Ballvora), pasi kjo e fundit nuk rezultonte të kishte jetuar të paktën 1 vit përpara vdekjes me trashëgimlënësen dhe të ishte në ngarkim të saj. Gjithashtu, sipas gjykatës së apelit, pretendimet e tjera të ngritura nga paditësja *në aktin e apelit* janë të pabazuara në ligj, pasi paditësja gjatë gjykimit në shkallë të parë nuk ka pretenduar shkaqe të tjera për pavlefshmërinë e testamentit, kështu që gjykata e shkallës së parë objektivisht dhe në përputhje me nenin 6 të KPC-së ka marrë në analizë dhe ka dhënë përgjigje për çfarë është kërkuar nga paditësja dhe vetëm për atë që është kërkuar.

46. Paditësja Sulltane Merja (Ballvora) ka paraqitur sërish rekurs, duke pretenduar se gjykata e apelit nuk kishte zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë dhe se padia e saj ishte ndërtuar me objekt kundërshtimin e testamentit bazuar në nenet 360 e vijues të KC-së, ndërsa në vendime është shkruar gabim sikur është kërkuar vetëm për nenet 360 dhe 379 të atij kodi. Në vijim, Gjykata e Lartë, me vendimin e vitit 2013, ka vendosur mospranimin e rekursit të paditëses, me arsyetimin e kufizuar se ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon ligji.

47. Për sa më lart, Gjykata vëren se kërkimi për pavlefshmërinë e testamentit për disponimin tej radhëve të trashëgimtarëve nuk është ngritur në padinë që ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor të mësipërm, si dhe nuk i është dhënë zgjidhje përfundimtare nga gjykatat e zakonshme. Këto të fundit janë shprehur se kërkimi në fjalë ishte ngritur në aktin e apelit prej paditëses, ndaj ishte jashtë objektit të shqyrtimit të çështjes dhe nuk mund të vendosej për të.

48. Ndërkohë, procesi gjyqësor i pushuar nga Gjykata e Lartë në vitin 2023 dhe që është objekt i ankimit kushtetues individual, është vënë në lëvizje prej kërkuesit, në cilësinë e paditësit, kundër subjektit të interesuar, në cilësinë e të padituri, me objekt "pavlefshmërinë e testamentit të testatores Haxhire Ballvora", bazuar në nenet 374, 377 dhe 379 të KC-së. Në ngritjen e kësaj padie, kërkuesi ka paraqitur, ndër të tjera, si shkaqe ligjore: i. subjekti i interesuar Shaqir Shtishi nuk përfshihet në rrethin e trashëgimtarëve; ii. kërkuesi është trashëgimtar i shtetases Fatmira Ballvora, motra e trashëgimlënëses Haxhire Ballvora; iii. testamenti ka cenuar rezervën ligjore të motrës së trashëgimlënëses, shtetases Fatmira Ballvora, e cila ishte person i paaftë për punë në ngarkim të Haxhire Ballvorës.

49. Nën dritën e rrethanave të mësipërme, Gjykata vëren se bëhet fjalë për dy procese gjyqësore, të cilat ndonëse kanë objekt dhe bazë ligjore të njëjtë, pavlefshmërinë e testamentit të testatores Haxhire Ballvora, sipas dispozitave të KC-së, ndryshojnë në lidhje me shkaqet ligjore të padive të ngritura. Kështu, procesi i vënë në lëvizje nga kërkuesi ka pasur në objektin e tij vlefshmërinë e testamentit për shkakun ligjor se ishte disponuar ndaj një personi në kundërshtim me ligjin, ndërsa procesi i mëparshëm i vënë në lëvizje nga Sulltane Merja Ballvora, ndonëse ka pasur të njëjtin objekt, atë të vlefshmërisë së testamentit, ka pasur si shkak ligjor prekjen e rezervës ligjore. Ndërkohë, analiza e Gjykatës së Lartë për këto rrethana përmban gabim faktik të dukshëm në përcaktimin se dy proceset gjyqësore kanë pasur shkaqe ligjore të njëjta, që kanë sjellë si rezultat edhe gabimin ligjor në interpretimin e gjësë së gjykuar, me pasojë pushimin e gjykimit të çështjes. Në këtë këndvështrim, Gjykata rithekson se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimet nr. 28, datë 18.5.2023; nr. 42, datë*

27.12.2022; nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese).

50. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, duke vendosur pushimin e gjykimit, ka sjellë si pasojë mungesën e zgjidhjes përfundimtare për kërkimin e kërkuesit për pavlefshmërinë e testamentit, në kushtet kur interpretimi i gjësë së gjykuar prej saj nuk ka qenë në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit. Kjo do të thotë se analiza nga ana e Gjykatës së Lartë përmban gabime faktike, të cilat nuk janë objektivisht të justifikueshme dhe të arsyeshme, çka ka sjellë edhe interpretimin e gabuar të ligjit në funksion të (mos)zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Rrjedhimisht, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

51. Në përfundim Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-4924(683), datë 22.11.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 28.10.2024.

Shpallur më 26.11.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen nr. 14 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, me kërkues Avenir Ballvora, edhe pse i bashkohemi shumicës në lidhje me zgjidhjen e saj, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-4924(683), datë 22.11.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë, qëndrimi ynë bazohet në një arsyetim të ndryshëm nga ajo për sa i përket cenimit të konstatuar në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

2. Shumica, me të drejtë, ka vërejtur se pretendimi i kërkuesit, në thelb, ka të bëjë me faktin se Gjykata e Lartë ka pushuar gjykimin, duke mos i dhënë zgjidhje përfundimtare kërkimit të padisë së tij për pavlefshmërinë e testamentit me arsyetimin se ai përbënte gjë të gjykuar dhe se për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi duhej të analizohej nëse interpretimi i gjësë së gjykuar prej Gjykatës së Lartë ka qenë në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit, ku për këtë do të verifikonte nëse arsyetimi i Gjykatës së Lartë përmbante gabime faktike ose ligjore, të cilat nuk janë objektivisht të justifikueshme dhe të arsyeshme *(shih paragrafin 39 të vendimit)*.

3. Në vijim, pasi është ndalur gjerësisht në evidentimin e fakteve relevante në lidhje me përputhshmërinë e dy proceseve gjyqësore në drejtim të palëve, objektit dhe shkakut ligjor të padisë, si dhe disponimeve respektive të gjykatave të zakonshme, shumica ka arritur në përfundimin se analiza e Gjykatës së Lartë përmban gabim faktik të dukshëm në përcaktimin se dy proceset gjyqësore kanë pasur shkaqe ligjore të njëjta, çka ka sjellë si rezultat edhe gabim ligjor në interpretimin e gjësë së gjykuar, me pasojë pushimin e gjykimit të çështjes *(shih paragrafët 40–49 të vendimit)*.

4. Në vlerësimin tonë, ndërsa arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk përmban ndonjë gabim faktik të dukshëm, i cili të ketë passjellë gabim ligjor në interpretimin e gjësë së gjykuar, çështja që ngrihet në këtë rast është nëse Gjykata e Lartë ka arsyetuar mjaftueshëm për të arritur në përfundime të caktuara ligjore përmes interpretimit të fakteve relevante. Në këtë kontekst, mendojmë se interpretimi i gjësë së gjykuar nga Gjykata e Lartë në raport me faktet e çështjes nuk ka qenë në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit, pra se ky

arsyetim është i pamjaftueshëm në aspektin kushtetues.

5. Mendojmë se faktet e evidentuara nga shumica, ashtu dhe ato të evidentuara nga Gjykata e Lartë në lidhje me gjënë e gjykuar, në thelb, nuk janë të ndryshme. Është e vërtetë se Gjykata e Lartë në vendimin e saj, për sa i përket procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga shtetasja Sulltane Merja, është shprehur se padia e saj ka pasur si shkak ligjor edhe nenin 377 të KC-së, ku pretendohej se nuk mund të disponohej me testament ndaj të paditurit Shaqir Shtishi, por, megjithatë, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit nuk janë shprehur për një pretendim të tillë. Nga ana tjetër, kjo rrethanë, pavarësisht pasaktësisë së saj në lidhje me shkakun ligjor të artikuluar të padisë, nuk duket se ka shërbyer për arritjen nga Gjykata e Lartë në përfundimin për qenien përpara gjësë së gjykuar. Në të vërtetë, për këtë përfundim, Gjykata e Lartë duket se i është referuar faktit se në rekursin e paditëses Sulltane Merja është pretenduar edhe pavlefshmëria e testamentit, sipas nenit 377 të KC-së, për shkakun se është disponuar ndaj një personi që nuk ka zotësi për të trashëguar me testament dhe se vullneti i testatores kufizohet nga kjo dispozitë. Pikërisht, referuar këtij fakti, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se gjykatat kanë analizuar vlefshmërinë e testamentit edhe nëse ai bie në kundërshtim me nenin 377 të KC-së dhe se, duke vendosur mospranimin e rekursit, Gjykata e Lartë në atë rast i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi, ndaj një pretendim i tillë nuk mund të ngrihej më nga asnjë palë që pretendon të drejta nga trashëgimlënësja (*shih paragrafët 41–42 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

6. Nisur nga kjo, vlerësojmë se arsyetimi i Gjykatës së Lartë për arritjen në përfundimin për qenien përpara gjësë së gjykuar, është i pamjaftueshëm. Për sa i përket kuptimit subjektiv të gjësë së gjykuar, konstatojmë se Gjykata e Lartë ka arsyetuar se qëndron në faktin se ajo që është vënë në bisedim (kërkimet, pretendimet, prapësimet), sipas parimit të kontradiktoritetit dhe që është vendosur në gjykim me anë të urdhërimeve të vendimit, është e detyrueshme për palët në gjykim, trashëgimtarët e tyre dhe personat që tërheqin të drejta nga ato (si në rastet e neneve 199 e 200 të KPC-së) (*shih paragrafin 44 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Megjithatë, në lidhje me rastin konkret, ajo gjykatë nuk arsyeton se përse fakti i ngritjes së atij pretendimi në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë mund të çojë në përfundimin se ai pretendim është shqyrtuar përfundimisht nga gjykatat, ndonëse përgjigja e vetme e dhënë nga Gjykata e Lartë në atë rast është mospranimi i rekursit me arsyetimin se ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon ligji. Për rrjedhojë, mosrespektimi i këtij elementi të standardit të arsyetimit të vendimit e lidhur me mungesën e arsyetimit të plotë nga Gjykata e Lartë, për sa i përket përfundimit të arritur prej saj se në rastin konkret ndërhyn parimi i gjësë së gjykuar, është i tillë që vë në dyshim edhe të drejtën e aksesit në gjykatë të kërkuesit, të lidhur me mënyrën se si ajo gjykatë ka trajtuar dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve të palëve, pra vetë të drejtën për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

Anëtarë: Marjana Semini, Ilir Toska

UDHËZIM
Nr. 980, datë 15.11.2024

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE MËNYRËS SË PARAQITJES SË KËRKESËS PËR MIRATIMIN SI PËRDORUES PËR TË USHTRUAR AKTIVITET BRENDA PARQEVE TEKNOLOGJIKE DHE SHKENCORE

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës; dhe të nenit 18, pika 3, të ligjit nr. 58/2022, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore"; të kreut I, pika 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 7.7.2023, "Për miratimin e procedurave për përzgjedhjen e përdoruesit në parqet teknologjike dhe shkencore".

UDHËZOJ:

Neni 1
Objekti

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i formës dhe mënyrës së paraqitjes së kërkesës për marrjen e miratimit si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parqeve teknologjike dhe shkencore.

Neni 2
Përkufizimi

1. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Aplikant" është kandidati që ka paraqitur kërkesën për miratimin si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parkut;

b) "Thirrje e hapur" është thirrja që publikon zhvilluesi në kuadër të procedurës për përzgjedhjen e përdoruesve.

Neni 3
E drejta për të aplikuar në cilësinë e përdoruesit

1. Çdo person fizik ose juridik, shqiptar ose i huaj, mund të paraqesë pranë zhvilluesit një shprehje paraprake interesi për marrjen e statusit si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor.

2. Formati i shprehjes së interesit paraprak është sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi.

3. Shprehja paraprake e interesit mund të dorëzohet në formë elektronike ose shkresore.

4. Çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pavarësisht nëse ka dorëzuar ose jo shprehjen e interesit, mund të paraqesë te zhvilluesi kërkesën për miratimin si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor.

Neni 4
Forma e kërkesës për marrjen e miratimit si përdorues

1. Kërkesa, sipas formatit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin për plotësimin e kërkesave tekniko-ligjore, sipas formularëve të mëposhtëm që i bashkëlidhen këtij udhëzimi:

a) Formulari 1 – Informacioni ligjoro-administrativ i aplikantit;

b) Formulari 2 – Formulari i vetëdeklarimit;

c) Formulari 3 – Studimi i fizibiliteti.

2. Aplikanti, pas njoftimit për paraqitjen e dokumenteve shtesë, dorëzon dokumentacionin e kërkuar nga zhvilluesi i parkut brenda një afati 30-(tridhjetë-)-ditor.

Neni 5
Mënyra e paraqitjes së kërkesës dhe afatet e aplikimit

1. Aplikantët për marrjen e miratimit si përdorues për të ushtruar aktivitet në parkun teknologjik dhe shkencor, duhet të paraqesin:

i) kërkesën;

ii) formularët që i bashkëlidhen kërkesës;

iii) dokumentacionin e kërkuar nga Zhvilluesi në Thirrjen e Hapur.

2. Aplikantët mund të dorëzojnë kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues në formë elektronike ose shkresore, sipas përcaktimeve në Thirrjen e Hapur.

3. Zhvilluesi i parkut teknologjik dhe shkencor rezervon të drejtën për të kërkuar informacione të mëtejshme mbi dokumentacionin e dorëzuar nga aplikanti.

4. Aplikantët mund të kërkojnë sqarime në lidhje me dokumentacionin e aplikimit në adresën e-*mail* të zhvilluesit, si dhe mund të vizitojnë hapësirën ku do të zhvillohet parku teknologjik, në përputhje me mundësitë teknike të zhvilluesit.

5. Aplikimet duhet të dorëzohen brenda afatit të përcaktuar nga Zhvilluesi në Thirrjen e Hapur.

Neni 6
Përfshirja e një institucioni të arsimit të lartë

1. Parashikimet në këtë udhëzim zbatohen dhe për përfshirjen në park të një institucioni të arsimit të lartë, vendas ose të huaj, të akreditуar sipas legjislacionit përkatës të vendit të origjinës.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

ANEKS 1
FORMATI I SHPREHJES SË INTERESIT PARAPRAK

SHPREHJE INTERESI PARAPRAKE

Data: [shto ditën, muajin dhe vitin]
Për: [shto emrin e Zhvilluesi i Parkut Teknologjik dhe Shkencor]
Nga: [shto emrin e subjektit që shpreh interesin]
Të nderuar,
Ne, të nënshkruarit, _____ (*emri i subjektit*), me numër regjistrimi të biznesit _____, me seli në adresën: _____, paraqesim shprehje interesi paraprake për marrjen e statusit si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor *[shto emrin e Parkut Teknologjik dhe Shkencor]* dhe deklarojmë se:

Parashikimet: Ne parashikojmë të aplikojmë për marrjen e statusit si përdorues të *[shto emrin e Parkut Teknologjik dhe Shkencor]* duke aplikuar mbi bazën e vlerësimeve paraprake si vijojnë:

i. nga veprimtaritë e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____._____._____, *[shto vendimin e Këshillit të Ministrave që jep miratimin për hapjen e parkut teknologjik dhe shkencor]* parashikojmë të kryejmë: _____ (*rendit veprimtaritë*);
ii. numri i punonjësve që do të angazhohen në këto veprimtari parashikohet të jetë _____ punonjës;
iii. të ardhurat vjetore nga veprimtaria në *[shto emrin e Parkut Teknologjik dhe Shkencor]* parashikohen të jenë _____ lekë/euro.

Rezerva: Kjo shprehje interesi paraprake jepet pa asnjë detyrim nga ana jonë për paraqitjen e një aplikimi për marrjen e statusit si përdorues i *[shto emrin e Parkut Teknologjik dhe Shkencor]* dhe asnjë detyrim ligjor nuk do të rrjedhë prej saj.

Me nderime,
_____
[emër, mbiemër i përfaqësuesit të autorizuar të subjektit]

Nënshkrimi _____

Adresa _____
[numrin e rrugës/qytetin ose adresën e qytetit/vendit]

FORMATI

KËRKESË PËR MIRATIMIN PËR TË USHTRUAR AKTIVITET BRENDA PARKUT TEKNOLOGJIK DHE SHKENCOR NË CILËSINË E PËRDORUESIT

Data: *[shto ditën, muajin dhe vitin]*

Për: *[shto emrin e Zhvilluesi i Parkut Teknologjik dhe Shkencor]*

Ne, të nënshkruarit, paraqesim kërkesën për të ushtruar aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor *[shto emrin e Parkut Teknologjik dhe Shkencor]* në cilësinë e përdoruesit dhe deklarojmë se:

Rezerva: Ne kemi shqyrtuar dhe nuk kemi rezerva për kushtet dhe kërkesat e kërkuara/shpallura nga *[shto emrin e Zhvilluesi i Parkut Teknologjik dhe Shkencor]* në cilësinë e Zhvilluesit të Parkut Teknologjik, për përzgjedhjen e përdoruesve të cilët do të ushtrojnë aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor.

Konflikt interesi: Nuk kemi konflikt interesi në përputhje me *[shto referencën e vendosur nga Zhvilluesi në Thirrjen e Hapur]*

Pranueshmëria: Ne plotësojmë kërkesat tekniko-ligjore për fitimin e statusit të përdoruesit në përputhje me kushtet e vendosura nga Zhvilluesi në Thirrjen e hapur;

Angazhimet: Ne angazhohemi të marrim përsipër sa vijon (*të listohen të gjitha kushtet e përzgjedhjes së përdoruesit të vendosura nga Zhvilluesi*):

i. _____;

ii. _____.

Përjashtimi nga detyrimet: Ne e kuptojmë që Zhvilluesi, pa asnjë detyrim ndaj aplikantëve, mund të anulojë procesin e përzgjedhjes në çdo kohë dhe se nuk është i detyruar të pranojë asnjë aplikim që mund të marrë dhe as të ftojë aplikantët si përdorues të parkut.

Vërtetësia dhe saktësia e informacionit: Të gjitha informacionet, deklaratat dhe përshkrimet e përfshira në kërkesë janë në të gjitha aspektet të vërteta, të sakta dhe të plota në bazë të njohurive tona më të mira. Ne, autorizojmë Zhvilluesin që të verifikojë informacionin dhe dokumentet bashkëlidhur me aplikimin.

Nënshkrimi _____ *[shëno nënshkrimin(et) e një përfaqësuesi(ve) të autorizuar të aplikantit]*

_____

Emri [shtoni emrin e plotë të personit që nënshkruan aplikimin]

Në cilësinë e _____ *[shëno cilësinë e personit që nënshkruan aplikimin]*

I autorizuar për të nënshkruar aplikimin për dhe në emër të: _____*[shënoni emrin e plotë të aplikantit]*

Adresa _____ *[shëno numrin e rrugës/qytetin ose adresën e qytetit/vendit]*

Datë _____ *[shëno numrin e datës, muajit, vitit]*

Formularët që i bashkëlidhen kërkesës *për miratimin si përdorues për të ushtruar aktivitet brenda parkut teknologjik dhe shkencor*

FORMULARI 1
INFORMACIONI LIGJOR-ADMINISTRATIV I APLIKANTIT

(*Për t'u plotësuar nga aplikanti*)
Data: *[shto ditën, muajin, vitin*]
Emri i Parkut: *[shto titullin]*

Faqe *[shto numrin e faqes]* prej *[shto numrin total]* faqet

Emri i aplikanttit *[shto emrin e plotë]*
Informacioni i përfaqësuesit të autorizuar të aplikantit Emri: *[shto emrin e plotë]* Adresa: *[shto rrugën/numrin/qytetin ose qytetin/shtetin]* Numrat e telefonit: *[shtoni numrat e telefonit, duke përfshirë kodet e shtetit dhe të qytetit]* Adresa e postës elektronike: *[shënoni adresën e postës elektronike]*
Sektori në të cilin aplikanti ushtron veprimtarinë:
Një përshkrim i shkurtër i aktivitetit të aplikantit, me theks në pajtueshmërinë me llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në këtë park:
1. Bashkangjitur janë dokumentat si vijojnë: a) ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e aplikantit, si dhe ekstraktin për historikun e aplikantit; b) dokumente të tjera shtesë që mund të kërkohen nga Zhvilluesi *Kur aplikanti për përdorues është person fizik, juridik, i huaj, duhet të paraqesë dokumentin zyrtar, i cili vërteton se aplikanti është i regjistruar në regjistrat përkatës tregtarë ose dokumente të ngjashme, të lëshuara nga institucionet përkatëse në shtetin e origjinës.* *Dokumentet e siguruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të notifikuara, në zbatim të legjislacionit në fuqi për ligjërimin e dokumentacionit të shtetasve të huaj që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.*

Nënshkruar *[shtoni nënshkrimin(t) e një përfaqësuesi(ve) të autorizuar të aplikantit në çdo faqe]*.

FORMULARI 2
FORMULARI I VETËDEKLARIMIT

(*Për t'u plotësuar nga aplikanti*)
Data: *[shto ditën, muajin, vitin*]
Emri i Parkut: *[shto titullin]*

Deklarata për veprimtarinë e aplikantit
Aplikanti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _____
Aplikanti nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _____
Aplikanti nuk është në proces falimentimi dhe kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit *Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* _____
Aplikanti nuk i nënshtrohet kufizimeve të mëposhtme: a) 25 ose më shumë për qind e kapitalit të autorizuar, direkt ose indirekt, i përket organeve të qeverisjes qendrore ose vendore; b) organizohet si organizatë jofitimprurëse, sipas përcaktimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse; c) në kapitalin e autorizuar të të cilit 25 për qind ose më shumë janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga persona juridikë të regjistruar, të shpallur në listën e financuesve të terrorizmit; ç) kur ai shpallet i falimentuar në përputhje me dispozitat në fuqi të ligjit për falimentimin; d) kur është në proces likuidimi, përveç transformimit.

Nënshkruar *[shtoni nënshkrimin(t) e një përfaqësuesi(ve) të autorizuar të aplikantit në çdo faqe]*.

FORMULARI 3
STUDIMI I FIZIBILITETIT

(Forma dhe përmbajtja e studimit të fizibilitetit që do të dorëzohet nga aplikanti përcaktohet nga Zhvilluesi i Parkut Teknologjik dhe Shkencor)

1. Studimi i fizibilitetit duhet të trajtojë të paktën çështjet e mëposhtme:

a) përshkrimi i aktivitetit teknologjik dhe inovativ që propozon të kryejë aplikanti;

b) përputhshmëria e veprimtarisë së aplikantit me llojin e aktiviteteve që kryhen në park, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave që autorizon hapjen e parkut;

c) kapaciteti financiar dhe menaxherial i aplikantit për realizimin e veprimtarisë së propozuar;

d) angazhimet, në lidhje me plotësimin e kriterit/ve të pjesëmarrjes së aplikantit në cilësinë e përdoruesit, në park, sipas përcaktimit në thirrje, pagimin e tarifave të shërbimeve apo çdo kërkesë tjetër të thirrjes.

e) plani i kohëzgjatjes së aktivitetit dhe mundësia e zgjerimit të tij;

f) përfitimet që merr aplikanti nga statusi i përdoruesit në parkun teknologjik;

g) aspektet ligjore dhe rregullatore që prekin aktivitetin e aplikantit;

h) risqet e identifikuara dhe plani i masave të zbutjes së tyre.

2. Zhvilluesi në thirrje mund të përcaktojë të tjera çështje që duhet të përfshihen në studimin e fizibilitetit.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/11/27 15:02:30 +02'00'
826bb1095bcf44a1b09d6427eb994143202411271
5022056031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)